



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:183456

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06646778

Ac.nr.1375/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehollli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Sh. nga Gjakova, Rr. "...", nr. ... të cilën me autorizim e përfaqëson avokati V.H., nga Prizreni, kundër të paditurit Sh.Sh., nga Prizreni, Rr. "...", nr...., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati S.K., nga Prizreni, për dorëzimin e paluajtshmerisë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1289/19 e datës 04.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 24/12/2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të autorizuarit të paditurit Sh.Sh., nga Prizreni, dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1289/19 e datës 04.02.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin ankimor C.nr.1289/19 e datës 04.02.2021, ka vendosur si vijon: Miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.Sh., nga Gjakova. Detyrohet i padituri Sh.Sh., nga Prizreni, të dorëzojë të lirë nga njerëzit dhe sendet, paluajtshmerinë e evidentuar si ngastër kadastrale nr. 05907-0 ZK Prizren, e cila gjendet në Qalapek, arë e klasit 4, me kulturë tokë bujqësore, në sipërfaqe të përgjithshme 7647m² dhe të lirë t'i dorëzon paditëses A.Sh., nga Gjakova, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nënë kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Si dhe të paguan shpenzimet e procedurës për paditësen në shumën e përgjithshme 549,00 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurit, duke e atakuar të njëjtin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

I autorizuari i paditëses ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:
-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 23.08.2019, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për lirim pronës, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Nga Certifikata për njësinë kadastrale 5907 datë 30.09.2019 gjykata ka vërtetuar që paditësja A.Sh., është pronare e vetme e kësaj ngastre e cila ka sipërfaqen e përgjithshme 7647 m². Nga Aktgjykimi i Gjykatës Komunale C.nr.161/75 date 26.09.1975, vërtetohet se është miratuar kërkesëpadija e paditësit F.G., nga Prizreni, i ati i këtu paditëses A.Sh., kundër të paditurve N.L., F.L., R.L. dhe B.L. Nga ky aktgjykim gjithashtu vërtetohet se të paditurit në përgjigjet në padi dhe theksimet që kanë paraqitur në atë lëndë e kanë pranuar në tersi kërkesëpadinë duke sqaruar që pas vdekjes së babës së tyre livadhin ja kanë shitur F.G. për shumën 22.000,00 dinar. Nga vërtetim i pagimit te tatimit për pronën e patundshme prej 20.590 dinarë, date 15.08.1977, e cila është si lloje vule mbrapa aktgjykimit C. Nr. 161/75, vërtetohet që i ati i paditëses ka paguar tatimin në qarkullim në shumën 20.590,00 dinar, pas miratimit të kërkesës dhe regjistrimit të asaj paluajtshmerie në librat kadastrale, Nga Procesverbal nr.I.br.352/79 date 08.06.1979 i Gjykatës Komunale në Prizren, vërtetohet që sipas propozimit për ekzekutim të propozuesit F.G., i ati i këtu paditëses A.Sh., kundër A.Sh. dhe N.Sh., ky i fundit vëllai i këtu të paditurit Sh.Sh., është kryer ekzekutimi i aktgjykimit të plotfuqishëm, ashtu që ngastra kadastrale nr. 5907, në sipërfaqe 0.76,47 ha, në vendin e quajtur “Collopek”, i është dorëzuar e lirë nga sendet dhe objektet propozuesit F.G., i ati i këtu paditëses A.G., si dhe janë njoftuar A.Sh. dhe N.Sh., që çfarëdo pengese që i bëjnë F.G. do të përgjigjen penalisht.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se nga kopja e planit e dates 28.07.1989 dhe lista poseduese per parcelën nr.5907-0 date 08.06.1990, vërtetohet që ngastra kadastrale nr. 5907 në sipërfaqe të përgjithshme 7647 m² evidentohet në emër të F.G., i ati i këtu paditëses. Nga kopja nga flete posedimi i lëshuar nga drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër ne Komunën e Prizrenit date 07.02.2005, vërtetohet që ngastra kadastrale nr. 5907 në sipërfaqe të përgjithshme 7647 m², tani evidentohet në emër të B.G., bashkëshortja e F.G., përkatësisht nëna e paditëses. Nga aktvendimi i trashëgimisë LRP .nr.4415/17, Ref.nr.731/2017 date 13.09.2017, vërtetohet që pas vdekjes së B.G., trashëgimtar ligjor janë shpelluar A.Sh. e vajzërisë G..., H.Sh., e vajzërisë G... dhe S.B., e vajzërisë G... Nga të ti këto trashëgimtare, paditësja A.Sh. e ka pranuar pjesën e trashëgimore e cila është përbërë nga ngastrat kadastrale nr. 1245-0, **5907-0** dhe 5750-0. Trashëgimtarët tjera H.Sh. dhe S.B., janë deklaruar se nuk e pranojnë pjesën e tyre trashëgimore. Nga Aktvendim i zyrës Komunale Kadastrale ne Prizren nr.07-463-04/127445/B date 26.12.2017 vërtetohet që është pranuar kërkesa e A.Sh. nga Gjakova, ashtu që është bërë bartja e pronësisë nga pronarja e mëparshme B.G., në këtu paditësen A.Sh. dhe atë ngastrat kadastrale nr. 1245-0, **5907-0** dhe 5750-0. Sipas aktvendimit të trashëgimisë. Nga raport mbi ekspertizën ndërtimore për sigurimin e provave nga eksperti L.M. date 21.08.2019, vërtetohet se në ngastrën kadastrale nr. 5907 është e ndërtuar një objekt, përkatësisht shtallë për ruajtjen e lopëve. Nga raporti dhe skica e ekspertit gjeodet date 31.10.2019, gjatë procedurës për sigurimin e provave, vërtetohet që objekti i ndërtuar në ngastrën kontestuese ndodhet në anën perëndimore të ngastrës. Me katëshmëri P+0 me dimensione 16.00 X 10.00. Nga fletëpagese nr.1501639, vërtetohet se në emër të Sh.Sh. është paguar shuma 100,00 € për kompanin Rajonale të Ujitjes “Radoniqi - Dukagjini” sh.a. Nga priznanica vërtetohet që N.Sh., si blerës ju ka paguar shitësve

R.L, R.L1. dhe B.L. shumën 2.700,000 dinar, për 85 ari në vendin e quajtur Qollopek. Nga kjo provë gjykata nuk ka vërtetuar faktin që N.Sh., vëllai i të paditurit Sh.Sh. ka blerë ngastrën kontestuese. Ky fakt nuk është vërtetuar pasi që ngastra kontestuese ka sipërfaqe të përgjithshme 7647 m², e jo 83 ari. Si dhe faktin që me aktgjykimin c. Nr. 161/75 datë 26.09.1975 është vërtetuar që ngastra konstetuese i është shitur nga të njëjtit shitës F.G., babai i paditëses. Në kuptim të nenit 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore, pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi. Në rastin konkretë paditësja A.Sh., në bazë të aktvendimit për trashëgimi është pronare e ngastrës kadastrale nr. 5907 ZK Prizren në sipërfaqe të përgjithshme 7647 m². Mbi këtë bazë kërkon edhe dorëzimin e kësaj ngastre nga i padituri Sh.Sh.. Kërkesë të cilën kjo gjykatë e ka miratuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurit, për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara dhe atë nga ekspertiza e gjeodezisë dhe certifikata pronësore Nr.07-029-2714-Ç-19 e datës 11/06/2019 është vërtetuar me të drejtë fakti relevant se paditësja është pronare juridik e pasurisë kontestuese P-71813068-05907-0, ndërsa nuk ishte kontestuese fakti se i padituri është shfrytëzues i pasurisë lëndore, po ashtu gjatë shqyrtimit kryesor i padituri me asnjë provë të vlefshme juridike nuk ka arritur të vërteton se pronën kontestuese e ka blerë nga pronari juridik dhe ka pasur raporte kontraktuale me paditësen apo paraardhësin e saj dhe në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për pretendimet e të paditurit e të cilat arsye i pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit. Në këtë situatë juridike ligjvënësi ka paraparë në nenin 319.1 të LPK-së, si vijon: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*, ndërsa neni 322.3 ka paraparë: *Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.*

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, pasi që në rastin konkret janë plotësuar edhe kushti ligjor i paraparë me nenin 18 par.1 të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore e cila dispozitë parasheh: *Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti*, ndërsa neni 93 i po këtij ligji gjithashtu parasheh: *Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*. Mandej, me nenin 1 të Protokollit shtesë të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore Paris, 20.III.1952 parashihet: *Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.1375/22, me datë 24/12/2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku